

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inxhinjere Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
№-i Prot. Proj. Prot. No. 194/26	
Org. Jendrica	ORR
Org. Unit	
№. Ifaqes	/
№. Stranica	
№. Pages	
PRISHTINË / A No.1	



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Nr. 07-BD/2026
Prishtinë: 17.03.2026

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.13 dhe 5.14 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20 dhe 1.21 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOshME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokollit 8648/24; dhe nenit 4, nenit 5 dhe nenit 9 të Rregullores për Edukim të Vazhdueshëm Profesional të Inxhinierëve të Licencuar, me qëllim të rregullimit të procedurës për njohjen e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional të realizuar jashtë aktiviteteve të organizuara nga Oda, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 17.03.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

- Miratohet procedura për paraqitjen, shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me kërkesat për njohjen e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional të realizuara nga inxhinierët e licencuar jashtë aktiviteteve të organizuara nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.
- Inxhinierët e licencuar kanë të drejtë të kërkojnë njohjen e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional të realizuara jashtë aktiviteteve të organizuara nga Oda, duke përfshirë por pa u kufizuar në:
 - trajnime profesionale;
 - seminare dhe konferenca profesionale;
 - punëtori profesionale;
 - ligjërata profesionale;
 - aktivitete të tjera të edukimit profesional të organizuara nga institucione akademike, organizata profesionale apo institucione të tjera relevante.
- Inxhinieri i licencuar paraqet kërkesë për njohjen e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm profesional në Administratën e Odës, përmes formularit të kërkesës i cili është bashkëngjitur këtij vendimi dhe përbën pjesë përbërëse të tij.
- Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës që dëshmon pjesëmarrjen dhe përmbajtjen profesionale të aktivitetit, si në vijim:
 - certifikatën ose dëshminë e pjesëmarrjes;
 - programin ose agjendën e aktivitetit;
 - të dhënat për organizatorin e aktivitetit;
 - dokument që dëshmon kohëzgjatjen e aktivitetit;
 - dokumente të tjera relevante që dëshmojnë përmbajtjen profesionale të aktivitetit.
- Administrata e Odës verifikon dokumentacionin e paraqitur dhe kontrollon nëse kërkesa është e plotë. Në rast se dokumentacioni është i paplotë, administrata kërkon plotësimin e tij nga aplikanti brenda afatit të arsyeshëm.
- Pas verifikimit administrativ të dokumentacionit, Administrata e Odës përmes Drejtorit Ekzekutiv e procedon kërkesën në Bordin Drejtues për shqyrtim dhe vendimmarrje.
- Bordi Drejtues vendos për:



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

- njohjen ose mosnjohjen e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm profesional;
 - numrin e pikëve kredituese që i atribuohen aktivitetit, në përputhje me Rregulloren për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të Inxhinierëve të Licencuar dhe në bazë të përmbajtjes profesionale dhe kohëzgjatjes së aktivitetit.
8. Bordi Drejtues rezervon të drejtën të kërkojë informacione ose dokumente shtesë lidhur me aktivitetin profesional, nëse vlerëson se kjo është e nevojshme për marrjen e vendimit.
 9. Administrata e Odës bën evidentimin e pikëve kredituese të miratuara në regjistrin përkatës të edukimit të vazhdueshëm profesional të inxhinierit të licencuar.
 10. Formulari i kërkesës për njohjen e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional, i bashkëngjitur këtij vendimi, është pjesë përbërëse e tij dhe publikohet së bashku me këtë vendim.
 11. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së _____ 
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____ 
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____ 
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
5. **Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____ 
7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____ 



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KËRKESË

Për njohjen e pikëve të edukimit të vazhdueshëm profesional të realizuara jashtë aktiviteteve të organizuara nga Oda.

Në bazë të Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të Inxhinierëve të Licencuar, paraqes këtë kërkesë për njohjen e pikëve kredituese nga aktiviteti i edukimit të vazhdueshëm profesional i realizuar jashtë aktiviteteve të organizuara nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.

1. TË DHËNAT E APLIKANTIT

Emri dhe mbiemri: _____

Numri Personal / ID: _____

Numri i licencës: _____

Fusha e inxhinierisë dhe drejtimi profesional:

Inxhinieri e Ndërtimit – drejtimi _____

Inxhinieri Mekanike – drejtimi _____

Inxhinieri Elektrike – drejtimi _____

Tjetër – drejtimi _____

Numri i telefonit: _____

Email: _____

2. TË DHËNAT PËR TRAJNIMIN / AKTIVITETIN PROFESIONAL

Titulli i aktivitetit / trajnimit:

Organizatori i aktivitetit:

Lloji i aktivitetit:

- Trajnim profesional
- Seminar
- Konferencë
- Punëtori
- Ligjëratë profesionale
- Aktivitet tjetër profesional

Vendi i mbajtjes së aktivitetit:

Data e mbajtjes së aktivitetit:

Kohëzgjatja e aktivitetit (numri i orëve / ditëve):

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit dhe përmbajtjes profesionale (temat kryesore të trajtuara):

3. DOKUMENTET E BASHKANGJITURA

Bashkë me këtë kërkesë bashkëngjis dokumentacionin që dëshmon pjesëmarrjen dhe përmbajtjen e aktivitetit profesional:

- Certifikatën e pjesëmarrjes
- Programin ose agjendën e aktivitetit
- Informacionin për organizatorin e aktivitetit
- Dokument që dëshmon kohëzgjatjen e aktivitetit
- Dokumente të tjera relevante (nëse ka)
- Materialet e aktivitetit / prezantimet / linku i aktivitetit (nëse ka)

4. DEKLARATA E APLIKANTIT

Deklaroj se të gjitha të dhënat e paraqitura në këtë kërkesë dhe dokumentet e bashkëngjitura janë të sakta dhe të vërteta.

Jam i vetëdijshëm se njohja e pikëve kredituese bëhet nga Bordi Drejtues i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, pas verifikimit administrativ të dokumentacionit dhe në përputhje me Rregulloren për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional.

Data: _____

Nënshkrimi i aplikantit: _____

5. PËR PËRDORIM ZYRTAR NGA ODA

Data e pranimit të kërkesës: _____

Kërkesa është:

e plotë

kërkohet plotësim i dokumentacionit

Emri i zyrtarit administrativ: _____

Nënshkrimi: _____